

Myrteza SHARRA

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

PROCESI I PUNËS ON-LINE, HEDHJA E KATALOGËVE

Përmbledhje: Përshkrimi i përgjithshëm i situatës së mbylljes së institucioneve të administratës publike me Vendim të Këshillit të Ministrave. Masat e marra nga DPA për vazhdimin e proceseve të punës nga shtëpia, konkretisht hedhja e katalogëve. Bashkëpunimi i punonjësve me njëri-tjetrin për problematika të ndryshme të dala të cilat nuk ishim ndeshur më parë. Asistenca e dhënë dhe vështirësitë e punonjësve të rinj të cilët nuk e njihnin sistemin.

Problematika të ndryshme të dala gjatë procesit të punës (përsëritja e fondit dhe vitit me emër tjetër, tituj të gjatë në formë rendi dite, institucionet e shkruara shkurt, tituj të vështirë për t'u lexuar dhe verifikimi i tyre në fond).

Përqasja e fondeve të vjetra dhe të mbyllura me sistemin, të cilat nuk kanë përdorur përpunimin tekniko-shkencor sipas modelit të AQSh-së, por kanë vepruar në mënyrë të pavarur (Komiteteve të Partisë së Rrethit, lista dhe nr. e fondit, titujt shumë të gjatë).

Pasurimi i fondeve të institucioneve vendore (siç janë Komitetet Ekzekutive të Rretheve, Komitetet e Partive të Rretheve etj.), përbëjnë një element të shtuar në sistemin on-line të kërkimit të studiuesve pasi deri sot këtyre fondeve u qaseshin vetëm nëpërmjet inventarëve fizikë pranë sallës së studimit në DPA.

Fjalë kyçe: Pandemi, katalog, katalog on-line, qasje, digjitalizim

Pandemia Covid-19 ndikoi edhe në procesin e zhvillimit të punës në institucionet e administratës shtetërore, qendrore dhe vendore. Kështu, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave mori masat që në fillim për parandalimin e përhapjes së sëmundjes Covid-19.¹ Kur zhvillimi i punës në kushte normale u pezullua, thujse të gjitha institucionet gjetën mënyrën alternative të zhvillimit të këtij procesit, atë on-line. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nisi disa procese pune të cilat filluan të zhvilloheshin nga shtëpia, gjithashtu dhe shërbimin për qytetarët me kërkesat social-juridike dhe me dokumentet e studiuesve të cilat u shërbyen po në formën elektronike për një

¹ Urdhër nr. 178, datë 11. 03. 2020, Për planin e masave organizative-administrative në kuadër të parandalimit të përhapjes së Covid-19.

pjesë të të interesuarve.² Procesi i hedhjes së inventarëve në katalogun on-line të DPA ishte një nga proceset më të rëndësishme.

Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm filloi procesi i punës së hedhjes së katalogëve on-line.³ Që në ditët e para filloi hedhja e titujve të inventarëve, ku puna ishte e strukturuar me tre grupe me nga një përgjegjës që kujdesej për mbarëvajtjen e procesit të punës dhe kontrollin me rigorozitet të punës së bërë nga specialistët sipas kriterëve arkivore të përcaktuara në normat tekniko-profesionale.⁴ Pas zhvillimit me sukses të proceseve të punës të grupeve të para, gjatë kohës u pa e nevojshme dhe u shtuan edhe tri grupe të tjera të cilat merreshin me hedhjen e katalogëve on-line⁵, gjë e cila çoi në përparimin e shpejtë në këtë proces duke rritur shpejt numrin e fondeve të hedhura.

Sistemi ishte i ri dhe duhej trajnim për specialistët, të cilën e mbuluan përgjegjësit e grupeve duke udhëzuar për problematikat që dilnin shpesh. Duke qenë se ky proces punë kishte filluar gradualisht në Arkivat Shtetërore Vendore, një pjesë fondesh ishin të hedhura, por të papërfunduara, prandaj shpeshherë bëheshin edhe ngatërresa. Problemi kryesor ishte që inventarët, për shkak të vjetërsisë së tyre, ishin hartuar në një mënyrë jo shumë serioze dhe jashtë rregullave të drejtshkrimit, gjë e cila u korrigjua duke sjell titujt në trajtën e saktë.

Në fondet e disa AShV-ve haseshin fonde të cilat kishin një përsëritje, ose ishin i njëjti institucion i cili, për shkak të ristrukturimit që kishin pasur institucionet, ose për shkak të emërtesave të tjera dhe funksioneve që kishin marrë, si fond i veçantë, gjë e cila ishte një problematikë që u zgjidh që në fillimet e saj, duke bërë verifikimet e duhura kryesisht nga punonjësit e AShV-ve përkatëse.

Gjendja e një pjese të inventarëve ishte e keqe, pasi ishin tejet të dëmtuar, e ndikuar kjo nga koha, faktorët e jashtëm, të cilët dëmtojnë letrën dhe kushtet e ruajtjes së tyre. Kjo sillte një tjetër problematikë, atë të mosleximit të qartë të fjalëve në tituj. Të gjithë këta tituj u mbajtën shënim dhe, sipas rastit, kur specialist ishte punonjësi pranë AShV-së përkatëse, bëhej verifikimi i titujve në fond dhe përcaktohej menjëherë në sistem në trajtën e tij të saktë, duke mos lënë vend për gabime apo anashkalime të cilat do të krijonin probleme kur titujt të bëheshin publikë dhe të ishin të qashtëm për studiuesit.

² Urdhër nr. 194, datë 24.03.2020, *Për aplikimin për kërkesat social-juridike gjatë periudhës së emergjencës prej Covid-19.*

³ Urdhër nr. 189, datë 17.03.2020, *Për disa masa shtesë në kuadër të parandalimit të përhapjes së Covid-19.*

⁴ Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, *Dispozita ligjore për arkivat në Republikën e Shqipërisë*, Tiranë, 2007.

⁵ Urdhër nr. 203, datë 01.04.2020, *Për disa ndryshime në listën e personave që do punojnë nga shtëpia.*

Një tjetër problematikë ishin emërtesat e institucioneve, të cilat në kohën e hartimit të akteve zyrtare ose të përpunimit tekniko-shkencor që ishte bërë nga arkivisti, ishin shënuar në tituj të dosjeve me akronime, por që në raste të caktuara disa institucione kishin akronimet e njëjta dhe krijohej konfuzion, megjithëse ishte një grup tjetër që punonte për zëvendësimin e shkurtimeve duke bërë që procesi i hedhjes së inventarëve të vazhdonte normalisht.⁶

Përveç fondeve të institucioneve vendore të administratës shtetërore, u punua edhe me komitetet e partive të rretheve.

Fondi i Komitetit të Partisë në veçanti dhe i institucioneve apo fondeve që ishin pjesë e Arkivit Qendror të Partisë në tërësi, në vetvete janë të mbushura me problematika. Që me themelimin e AQP-së organizimi i punës ka kaluar në disa etapa.⁷ Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve ka ndryshuar disa herë, duke qenë se puna e parë ka qenë jocilësore dhe jo e përshtatshme për studim dhe shfrytëzim. Asistenca për këtë pjesë erdhi nga specialistë të Bashkimit Sovjetik.⁸ Në etapën tjetër përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve të AQP-së ndryshon sërish.⁹ Përpunimi tekniko-shkencor dhe hartimi i inventarit është shumë i ndryshëm nga institucionet të cilat sipas detyrimit ligjor dorëzonin dokumentacionin në Arkivin Qendror Shtetëror. Pra, thënë ndryshe, fondet e ish-Arkivit Qendror të Partisë së Punës Shqipërisë janë jashtë sistemit të metodologjisë së përpunimit tekniko-shkencor të AQSh-së.

Veprimtaria e tyre deri-diku e pavarur nga pikëpamja arkivore ka sjellë një ndryshim të formës së përpunimit dhe krijimit të njësive të ruajtjes. Ky problem vihej re menjëherë në inventarët e këtyre fondeve që nuk ishin në përputhje me normat tekniko-profesionale, pasi titujt ishin shumë të gjatë¹⁰, gati në formën e rendit të ditës duke zënë shpesh më shumë se një faqe inventari. Kjo krijonte problematika në llogaritjen e normave pasi hapësira që zinin këta tituj ishte tejet e madhe dhe për këtë u pa e arsyeshme që të llogariteshin me më shumë se një titull në nivelin e normës ditore të punës.¹¹

Problematikë tjetër, e cila vjen po nga metoda e përpunimit tekniko-shkencor, e hasur gjatë punës me këtë fond, janë listat. Brenda inventarit të një viti rezultojnë disa dosje me numër të njëjtë dhe strukturat e njëjta, por ato janë të ndara në lista. Katalogu, duke qenë i hartuar në mënyrë standarde dhe i mbështetur te normat tekniko-shkencore, nuk e njihete

⁶ Urdhër nr. 192, datë 19.03.2020, *Për disa ndryshime në listën e personave që do të punojnë nga shtëpia.*

⁷ Kujtim Nako, *Historia e Arkivit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë*, (Kristalina-KH, Tiranë, 2004), f. 11.

⁸ Po aty f. 49.

⁹ Po aty f. 87.

¹⁰ Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, *Dispozita ligjore për arkivat në Republikën e Shqipërisë*, Tiranë, 2009, f. 58.

¹¹ Urdhër nr. 189.

sistemin e metodologjisë së përpunimit dhe hartimit të inventarit të përdorur nga arkivistët në këto фонде. Kështu lindi nevoja e një adaptimi, duke shënuar vitin me fraksion për herë të dytë në sistem dhe duke cilësuar numrin e listës dhe të fondit të cilit i korrespondonte, kështu është një orientim më i mirë dhe me specifik për studiuesin, pasi mund të krijojë konfuzion kur shohim brenda të njëjtit fond disa njësi ruajtje me të njëjtin numër. Kjo nuk është një zgjidhje përfundimtare, pasi për problematika të tilla duhen përcaktuar qartë mënyra se si do të veprohet në të ardhmen, por duke qenë të kushtëzuar nga ambienti, kontakti, situata, u ra dakord që kjo të ishte një zgjidhje e përkohshme.

Këto ishin problemet më madhore të hasura gjatë procesit të punës on-line me katalogët, të cilat gjetën një zgjidhje të shpejtë falë edhe bashkëpunimit të shkëlqyer midis specialistëve dhe përgjegjësve të grupeve që diskutonin për problematikën dhe jepnin zgjidhje të shpejta dhe tejet praktike duke mos penguar vijueshmërinë e punës.

Në një statistikë të përgjithshme, gjatë procesit të punës nga shtëpia, gjatë kohës së mbylljes së institucionit janë hedhur në katalogun on-line mbi 80 000 tituj të cilët do të jenë shumë shpejt në dispozicion të studiuesve. Pasurimi i katalogut me fondet e institucioneve vendore (siç janë, p. sh., komitetet ekzekutive të rretheve, kooperativat bujqësore, këshillat popullore, ndërmarrje të ndryshme, komitetet e partive të rretheve etj.), përbëjnë një element të shtuar në sistemin on-line të kërkimit.

Studiuesit tanimë mund t'i shohin këta tituj që nga shtëpia pasi deri sot këtyre фондеve u qaseshin vetëm nëpërmjet inventarëve fizikë pranë sallës së studimit në DPA. Procesi është në vazhdim dhe plani është që të përfundojnë sa më shpejt në mënyrë që qasja on-line të jetë gjithëpërfshirës dhe të mos ketë mungesa të asnjë fondi të vetëm gjë e cila do të sillte lehtësira në studimin e këtyre фондеve, që deri në këto çaste nuk kanë qenë në optikën e parë të studiuesve. Duke pasur parasysh prapambetjen e madhe të digjitalizimit të inventarëve fizikë të фондеve të institucioneve vendore dhe numrin tejet të madh të këtyre фондеve kërkohet kohë.

Me nismën për hedhjen e këtyre titujve në katalogun on-line është një nga format e materialeve të informimit që DPA ofron dhe shumë shpejt mund të marrë formë edhe studimi i historisë lokale gjatë periudhës së komunizmit, pasi deri sot nuk ka pasur asnjë përpjekje për hedhjen e këtyre фондеve në sistemin e kërkimit që ofronte DPA për studiuesit dhe rrjedhimisht, nuk ka thuar asnjë studim të kësaj periudhe të mbështetur në fondet e institucioneve lokale.

Bibliografi:

Dokumente publike:

Urdhër nr. 178, datë 11.03.2020, “Për planin e masave organizative-administrative në kuadër të parandalimit të përhapjes së Covid-19”

Urdhër nr. 189, datë 17.03.2020 “Për disa masa shtesë në kuadër të parandalimit të përhapjes së Covid-19”

Urdhër nr. 192, datë 19.03.2020 “Për disa ndryshime në listën e personave që do të punojnë nga shtëpia”

Urdhër nr. 194, datë 24.03.2020 “Për aplikimin për kërkesat social-juridike gjatë periudhës së emergjencës prej Covid-19”

Urdhër nr. 203, datë 01.04.2020 “Për disa ndryshime në listën e personave që do të punojnë nga shtëpia”

Burime dytësore:

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. *Dispozita ligjore për arkivat në Republikën e Shqipërisë*. Tiranë, 2009

Nako, Kujtim. *Historia e Arkivit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë*. Tiranë, *Kristalina-KH*, 2004

